



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.39/2018

Prishtinë, më 5 dhjetor 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Sylja, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviç, Saranda Bogujevci dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Selman Hoti, Izet Rushiti dhe Petrit Pepaj, ZRRE; Mehdi Geci, Suzana Gashi, IAP; Pajtim Çuni “Radio Kosova”; Vatra Qehaja, LVV; Dragana Pajaniq, RTK 2; Donika Bekteshi, KDI; Alberta Hashani, KTV; Ismail Shabani “Kosova press”; Valmira Hoti, RTV 21 dhe Zana Ulaj, praktikante, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Raportim lidhur me zbatimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me faturimin e energjisë eklektike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi në seancën plenare të mbajtur më 9 shkurt 2018. Të ftuar: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe avokati i Popullit;
2. Të ndryshme.

\* \* \*

**Kryetarja**, tha se kemi të ftuar përfaqësuesit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, ndërsa nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk i janë përgjigjur ftesës, me arsyen se ministri ka pasur udhëtim zyrtar. Ajo tha se do të diskutojmë lidhur me zbatimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me faturimin e energjisë eklektike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi në seancën plenare, të mbajtur më 9 shkurt 2018 dhe anëtarëve të komisionit iu intereson të dinë, se çfarë ka bërë ZRRE lidhur me këto tri rekomandime?

**Izet Rushiti**, lidhur me ato tri rekomandime, theksoi se në bazë të rekomandimit numër një, është ndërprerë faturimi i energjisë në këto komuna edhe pas miratimit të dy parametrave rregullatorë, energjia elektrike e shpenzuar në komunat veriore nuk ka hyrë në tarifën e konsumatorëve të të gjitha kategorive. Kjo do të thotë që ky rekomandim është zbatuar dhe është përmbushur.

Sa i përket rekomandimit të dytë, ZRRE, bashkë me Qeverinë e Republikës, me KOST-in dhe Kuvendin e Kosovës, kemi bërë disa shkresa dhe takime bashkë me këto institucione, për të gjetur alternativën e furnizimit për këto komuna dhe njëherësh edhe pagesën e energjisë elektrike, në bazë të këtyre vendimeve që janë marrë. Ne kemi bërë disa takime me përfaqësues të Qeverisë dhe është formuar edhe një grup punues, që do të punojë rreth kësaj çështjeje. Ne, si ZRRE, por edhe institucionet tjera, kemi dërguar anëtarë në këtë grup punues.

Sa i përket rekomandimit numër tre për kompensimin e energjisë e cila iu është faturuar qytetarëve të Kosovës, një vendim nga gjykata kompetente, momentalisht është një vendim i përkohshëm deri në marrjen e një vendimi të prerë nga gjykata, dhe pas këtij vendimi, ZRRE do të marrë vendime dhe do të punojë sipas vendimit përfundimtar të gjykatës kompetente.

Kjo lëndë është ende në gjykatë dhe deri tani nuk e ka formën përfundimtare.

**Mehdi Geci**, tha se ne e kemi nxjerrë një raport me rekomandime, pastaj kemi bërë një kërkesë për shtyrjen, pezullimin e ekzekutimit të vendimit që gjithashtu edhe Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e kanë lënë në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRRE-së, numër 399 të vitit 2012. Gjithashtu, në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, e kemi paraqitur padinë në Gjykatën Themelore, më 15 gusht 2017 dhe jemi duke pritur nga gjykata që të anulohet vendimi i ZRRE-së dhe të bëjë kompensimin e konsumatorëve, të cilët faturohen për shpenzimin e energjisë elektrike për katër komunat veriore, kështu që jemi duke pritur vendimin që gjykata të vendosë çështje meritore, lidhur me këtë.

**Teuta Haxhiu**, tha se e mira e kësaj është që nga dhjetori i vitit të kaluar nuk po faturohen më qytetarët e Republikës së Kosovës, siç është grumbulluar borxhi prej 50 milionë euro. Tani ka mbetur pjesa tjetër e kthimit të borxhit, që qytetarët e kanë paguar, pa i pyetur askush. Si anëtare në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, kërkoj që edhe rekomandimet tjera të Kuvendit të Kosovës, të zbatohen. Fatkeqësisht, shumë herë rekomandimet apo rezolutat e Kuvendit mbesin në letër, sidomos në të kaluarën, asnjëherë nuk janë marrë parasysh, mirëpo nuk do të thotë që do të ndalemi për të kërkuar që të kthehet borxhi, sepse janë shkelur të drejtat elementare të njeriut. Pra, nuk do të thotë që po pajtohemi që gjithçka është në rregull, por

është një hap shumë i rëndësishëm, sepse për herë të parë dikush i tha stop kësaj dukurie, prandaj ne do të veprojmë që edhe këto dy rekomandimet tjera të zbatohen.

**Mirjeta Kalludra**, pyeti se cilat veprime i ka ndërmarrë ZRRE-ja që ti kompensoje konsumatorët të cilët padrejtësisht për vite të tëra janë faturuar për energjinë, të cilën nuk e kanë shpenzuar, në këtë rast konsumatorët, a kanë të drejtën e kthimit të shumës të cilën e kanë paguar? U tha se nuk po mbulohet më ajo pjesë nga qytetarët e Republikës së Kosovës për pjesën veriore. Pra, tani kush e paguan energjinë e shpenzuar të qytetarëve ne anën e veriut? Sa është konsumi i energjisë elektrike në këtë pjesë dhe sa është vlera monetare e gjithë kësaj energjie? ZRRE-ja dhe KEDS-i, cilat veprime i kanë ndërmarrë për t’u shmangur humbjeve në këto komuna dhe në tërë territorin e vendit. Pra, humbjet që ndodhin mos t’u faturohen qytetarëve, të mos paguajnë për diçka që nuk e kanë shpenzuar. Në këtë rast, edhe nëse paguan Qeveria, prapë kjo bëhet me taksat e qytetarëve, që do të thotë se është e njëjta situatë. Kurse, për përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit, a ka përfunduar çështja për padi nga ana e avokatit të popullit, e cila është parashtruar në gjykatë, lidhur me këtë çështje? Marrëveshja e Brukselit për energjinë, a është duke u zbatuar, nëse jo, cilat veprime i keni ndërmarrë që të fillojë zbatimi?

**Mexhide Mjaku- Topalli**, theksoi se të gjithë qytetarët kanë qenë të ngarkuar me tarifa, të cilat nuk i kanë shpenzuar dhe ka qenë një shkelje e të drejtave të njeriut. Ka qenë shumë shqetësuese dhe kemi kërkuar që të diskutohet në Kuvendin e Kosovës dhe pastaj të nxirren rekomandime, dhe nga ato rekomandime, tashmë jemi këtu për të diskutuar se a kanë gjetur zbatim. U tha se rekomandimi numër një është zbatuar. Kemi informatë që Kryeministri ka paguar një milion euro, për të mbuluar shpenzimet me energji elektrike për komunat serbe në veri, në muajin mars të këtij viti, në mënyrë që të evitohet përjashtimi i KOST-it nga organizata evropiane.

Çfarë do të bëhet në muajin mars të vitit 2019, cila është zgjidhja, a do të ketë prapë mbulesa të shpenzimeve nga Qeveria apo ndoshta kjo marrëveshja e fundit, që është me “Elektroseverin”, a është nënshkruar apo jo? U tha se sa i përket rekomandimit të dytë janë formuar grupe punuese, për të punuar në këtë drejtim, për t’iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke i trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë. Ne kemi informata se Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka hartuar një strategji 10 vjeçare, ku përmendet edhe shmangia e reduktimit të energjisë elektrike. Nga ky shkurtrim i energjisë, nga një studim amerikan, konfirmohet se ka 300 milionë euro humbje nga këto shkurtesa për bizneset. Kush do të merret me këtë çështje, ministria, ZRRE-ja, që të mos kemi reduktime, sepse edhe Kryeministri ka thënë që neve nuk na intereson për KEDS-in, se a ka mungesë të buxhetit apo instalimet janë të vjetra. Kam informata se gjatë vitit ka humbje, 32%, humbje teknike komerciale të energjisë elektrike, a është e vërtetë kjo? Sepse, këto janë shumë humbje të larta, pa marrë parasysh a është shpenzimi i energjisë në veri a janë instalimet e vjetra apo dikush në mënyrë tinëzare e shfrytëzon energjinë elektrike. Kjo është çështje që po i kushton qytetarëve të Republikës së Kosovës. Vendimin që e ka marrë ZRRE-ja për faturimin e qytetarëve për energjinë e shpenzuar në veri, pse tani nuk po ka mundësi që të merret vendimi për t’i kompensuar qytetarët, por po e pritni gjykatën, përderisa keni pasur të drejtë të faturoni qytetarët tani nuk po keni të drejtë që t’i zbritni faturat për ta kompensuar formën e dënimit që nuk e kanë merituar, theksoi ajo.

**Kryetarja**, tha se ju keni mbuluar humbjet, vitin e kaluar, a jemi prapë këtu që edhe këtë vit të mbulohen humbjet? Reduktimet janë nonsntop, a është kjo shkelje e të drejtave të njeriut? Ju

keni nënshkruar ndërtimin e hidrocentralit të vogël, njerëzit kosovarë kanë investuar, kanë punësuar njerëz dhe tash Komuna e Dragashit ka hidrocentralin e vogël, i cili nuk mund të jetë pjesë e rrethit. Çfarë ka ndodhur, a kemi prapë probleme me firma private, a keni ide se si mund të dalim prej situatës, sepse me këto probleme që janë, po pësojnë qytetarët e Kosovës.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, theksoi se nga po furnizohen tani qytetarët e komunave veriore, sepse ka pasur disa dilema se e marrin energjinë nga KEDS-i. Nëse janë duke u furnizuar nga KEDS-i, atëherë a po inkasohen këta qytetarë, inkasantët a po futen në shtëpitë e tyre që t'i monitorojnë dhe për ta përcjellë gjendjen se sa po shpenzojnë, a po paguajnë energji elektrike që po e shpenzojnë qytetarët në veri, dhe nëse nuk e paguajnë çfarë po ndodh me ta, a po u ndërpritet energjia elektrike, sikurse qytetarëve në pjesën tjetër të Kosovës? Çka është duke ndodhur me energjinë elektrike në nivel vendi? Kemi probleme gjithandej, përderisa e dimë që qytetarët janë duke e paguar energjinë, dhe në qoftë se nuk paguhet energjia, ata po i marrin ndëshkimet e tjera. Çfarë po ndodh me këtë situatë, të cilën jemi duke e kaluar, pikërisht në ditët kur është ndryshimi i motit dhe kemi familje, të cilat ngrohen vetëm me energji elektrike?

**Shemi Syla**, pyeti: A vazhdojnë ende faturat të shkojnë në dëm të qytetarit dhe a janë marrë masat që kjo praktikë të ndërpritet? Prej kujt po furnizohet tani pjesa në veri, çka po bëhet për një operator të palicencuar që është atje?

**Petrit Pepaj**, tha se e kemi një vendim të përkohshëm të gjykatës, e cila ka kërkuar shfuqizimin e vendimit 399, të vitit 2012. Përderisa nuk e kemi një formë të vendimit të prerë nga gjykata për ligjshmëri ose paligjshmërinë e atij vendimi, është e pamundur të bëhet një veprim tjetër, për shkak se po e marrim një hap para se gjykata të vërtetojë ligjshmërinë. Kështu që, ZRRE-ja është e pafuqishme të veprojë deri në momentin kur gjykata ta ketë një formë të prerë të vendimit. Pra, në momentin që kemi një vendim të gjykatës, sigurisht që do të merren veprime adekuate konform legjislacionit në fuqi.

Republika e Kosovës, sidomos aktorët që veprojnë në sektorin e energjisë, kanë obligim për furnizimin e qytetarëve në gjithë vendin, pavarësisht se ku ndodhen. Energjia elektrike, në pjesën veriore të Kosovës, furnizohet nga operatori i sistemit të transmetimit, që në këtë rast, është KOST-i, mirëpo kostoja për mbulimin e asaj energjie nuk është duke u bërë. Do të thotë, obligimi ligjor për furnizim ekziston, ndërsa obligimi financiar për mbulimin e asaj kostoje nuk ekziston, për shkak se nuk kemi një vendim të gjykatës që e ndalon mënyrën e financimit të asaj energjie. Ajo energji, për momentin, është duke u marrë prej operatorëve të Evropës dhe është duke u dërguar në pjesën veriore të Kosovës. Furnizimi atje është duke u bërë nga Kosova, mirëpo duke marrë energjinë prej operatorëve tjerë evropianë. Ju e dini që kjo de-balancë ka shkaktuar edhe një problem që ka devijuar edhe orët e Bashkimit Evropian dhe është një shqetësim. Është një problematikë që është duke u marrë Qeveria, Kuvendi, KOST-i, ZRRE-ja dhe të gjithë aktorët e mundshëm me operatorët e Bashkimit Evropian, që të mund të gjendet zgjidhja përfundimtare e kësaj çështjeje.

Nuk jemi pjesë e rrjetit të operatorëve evropianë dhe nuk është faji tek institucionet e vendit. Marrëveshja për energjinë është nënshkruar, mirëpo kjo marrëveshje kërkon që një kompani duhet të themelohet në pjesën veriore që quhet "Elektrosever", që do t'i marrë obligimet e furnizimit të konsumatorëve në atë pjesë të vendit. Momentalisht, kompania është e regjistruar sipas ligjeve të Kosovës, në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, mirëpo ende nuk ka aplikuar për marrjen e licencës.

Ne kemi mbajtur një takim, bashkë me KOST- in në Bruksel, me ndërmjetësimin e ENSO-s, që është organizata e operatorëve të Evropës, për shkak se Kosova i ka përmbushur të gjitha obligimet, në këtë rast, i ka bërë presion palës serbe, që sa më shpejt që është e mundur të aplikojnë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, për licencë.

**Kryetarja** theksoi se ka informata që ata kanë aplikuar, por nuk kanë respektuar emrin e Kosovës dhe ne kemi refuzuar dhe ata tani janë duke e bllokuar Kosovën, që të jetë pjesë e ENSO-s.

**Petrit Pepaj**, tha se është bërë regjistrimi, sepse kjo ka qenë pengesa. Kosova ka shprehur vullnetin e saj, e ka regjistruar kompaninë.

**Teuta Haxhiu**, pyeti: A nënkupton kjo që është gjithçka në rregull me dokumentet e Republikës së Kosovës?

**Petrit Pepaj**, tha se përderisa shkruan në certifikatën e biznesit, Republika e Kosovës, neve kjo na duhet, pra është regjistruar, është hapi i dytë që po pritët për ta dorëzuar aplikacionin për licencim. Në ndërkohë, po presim mos ka ndonjë lëvizje dhe në momentin kur regjistrohet kjo kompani, merr obligimet dhe çështjet më nuk diskutohen. Momentalisht, sa jemi ne në dijeni atje, sepse operon një operator që nuk ka licencë dhe vepron në mënyrë të jashtëligjshme.

**Shemsi Sylja**, pyeti: Cili është ai operator që vepron në mënyrë të jashtëligjshme në veri të vendit?

**Petrit Pepaj**, tha se jemi në dijeni që është një operator serb që quhet “Elektrokosmet”, meqenëse jemi të privuar nga e drejta e qasjes në atë pjesë, si ZRRE, por edhe operatorët që i kemi të licencuar, do të thotë e gjithë kjo situatë ka ndodhur jo për vullnetin ose mosgatishmërinë e institucioneve të Kosovës që të mos operojnë në atë vend, mirëpo është në pyetje çështja e sigurisë, sepse nuk mundemi që ti detyrojmë punëtorët ose operatorët që të shkojnë pa një marrëveshje. Ekziston një marrëveshje ndërmjet dy shteteve e cila duhet të zbatohet. Po ashtu, po presim se cilat masa duhet të ndërmerren, në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet përfundimisht.

U përmend 1 milion euro të dhëna nga Qeveria e Kosovës. Në mars të këtij viti, ajo ka qenë një kërkesë e domosdoshme për ruajtjen e stabilitetit edhe sistemit tonë elektroenergjitë, për shkak se kanë qenë variacionet që të kemi ndalje totale prej ENSO- s të energjisë elektrike dhe e kemi pasur një situatë jashtëzakonisht të rëndë. Po ashtu, ka qenë e domosdoshme ndërhyrja e shtetit, në mënyrë që Kosova ta tejkalojë një kërkesë të domosdoshme prej operatorëve.

Rregullatori ka përgjegjësi të madhe, në këtë drejtim, për shkak se është institucioni i cili ia rregullon sektorin e energjisë elektrike, si në aspektin e çmimeve, ashtu edhe në aspektin e operimeve. Pra, do të thotë, përderisa jemi të privuar në këtë situatë, ne jemi edhe të shqetësuar, sepse nuk e dimë sesi do t’i vijë përfundimi. Është çështje politike nuk është thjeshtë çështje teknike, meqenëse është çështje politike është duke u marrë Qeveria, që të gjendet zgjidhja.

Ai tha se “Elektroseveri” është një kompani që vepron me ligje të Kosovës, përderisa licencohet dhe i nënshtrohet ligjeve të Kosovës, nuk besoj që ka ndonjë problem. Ne kemi të licencuar edhe HEP-in e Kroacisë, e kemi edhe GSA-në e Shqipërisë. Kosova e ka liberalizuar tregun dhe çdokush është i mirëseardhur në Kosovë, për këtë çështje.

**Teuta Haxhiu**, më herët thatë që kanë aplikuar dhe janë regjistruar dhe ky regjistrim ka ndodhur mbi dokumentet ku shkruan Republika e Kosovës, tani licencimi, çka më shumë, cilat dokumente shtesë ose çka duhet më shumë?

**Petrit Pepaj**, tha se licencimi është një dokument, për të cilin i licencuari merr obligime dhe detyrime ndaj konsumatorëve, merr obligime që i nënshtrohet rregullave të tregut dhe rregullave që i ka Republika e Kosovës. Gjithashtu, merr obligime ndaj konsumatorëve të vet, të cilët ai pretendon t'i furnizojë, por edhe ndëshkimet në rastet kur nuk i përmbahen rregullave dhe kushteve të licencës, që janë të përcaktuara.

**Kryetarja** pyeti: deri sot, a keni pasur edhe ndonjë një dënim shtesë? Kosova është vend i vogël, jam e sigurt që jeni të informuar që në Dragash nuk ka pasur energji elektrike 6 ditë.

**Petrit Pepaj**, tha se në rrjetin elektrik nuk mund të punosh në tension, sepse është rrezik. Sipas standardeve teknike, kushdo që punon në shtylla, kushdo që punon në stacione, aty duhet të punohet pa energji ose përndryshe rrezikohet jeta e punëtorit. Janë në mirëmbajtje dhe janë disa investime që janë duke u kryer dhe kërkohet të ndalet rryma dhe ato janë të paralajmëruara. Ne e kemi ndaluar pikërisht edhe këtë veprim, kemi thënë që edhe ndërprerje për shkak të planifikimit që e kemi në mirëmbajtje, nuk mund ta bësh në sezonin e ftohtë të vitit. Kjo praktikë është ndërprerë dhe nuk mund të bëhen ndërprerje, që ta bëjë atë mirëmbajtje në sezonin kur ka temperatura të ulëta.

**Lirije Kajtazi**, tha se ju keni thënë që keni pritur që të lëshohen në operim Kosova A dhe B, ku është problemi, konkretisht pse nuk janë lëshuar dhe a kemi gabuar që kemi falë distribucionin dhe sa janë treguar seriozë ata në obligimet që i kanë blerë me para të imta këtë pasuri shtetërore?

**Petrit Pepaj**, tha se është në plan që më 15 dhjetor 2018, të hyjë në operim njësi gjeneruese B1, shpresojmë që nuk do të kemi ndonjë problem, sepse është kapitale. Deri tash, sa jemi të informuar, testimet kanë shkuar në rregull dhe nuk besoj se do të ketë ndonjë problem. Ndërsa, A3 ka pasur një rrjedhje të kaldajës dhe siç na ka shpjeguar menaxhmenti i KEKU-t, është një rrjedhje në pozicion tepër të vështirë dhe i kemi parë se në çfarë forme kanë filluar punëtorët që ta eliminojnë atë rrjedhje atje. Janë elektrana të vjetra, më shume se 60 vjet dhe është problem, nuk mundet askush të sigurojë se ato do të operojnë, pa pasur ndonjë rrjedhje, pavarësisht që investohet, teknikisht është e rëndë dhe e kanë bërë të pamundurën. Më duket se po eliminohet ajo prishje.

**Teuta Haxhiu**, tha se aktualisht, qytetarët paguajnë 35 milionë euro, për shkak të humbjeve të energjisë, humbje që po i shkaktohen gjoja KEDS-it. Kjo është pjesë tjetër jashtë atij borxhi që e kanë paguar i gjithë populli 6 vite.

**Petrit Pepaj**, theksoi se në qoftë se nuk doni që ato humbje të njihen në tarifa, duhet ta ndryshoni ligjin, përderisa ligji në fuqi thotë: "Gjate miratimit të tarifave, ZRRE-ja duhet t'i njohë kostot e arsyeshme të nivelit të humbjeve në nivelin transmetimeve".

**Mexhide Mjaku-Topalli**, pyeti: Punëtorët që punojnë në kushte të vështira, a paguhen për rrezikshmërinë?

**Petrit Pepaj**, të them të drejtën nuk jam i sigurt, ne nuk jemi përgjegjës.

**Lirije Kajtazi**, sa po është serioz distribucioni, a i është përmbajtur kontratës?

**Petrit Pepaj**, u përgjigj dhe theksoi se në aspektin institucional nuk kam përgjigje, sepse nuk kemi një vlerësim të bordit sesi është bërë privatizimi, sepse ato procedura i ka bërë Qeveria. Sektori është zinxhir: KEK, KOST, KEDS, njëra prej hallkave që dështon, por është përpjekje për përmirësim të furnizimit me energji elektrike. Detyra jonë kryesore është që të mbrojmë konsumatorin, sepse ky është misioni i ZRRE-së.

**Suzana Gashi**, tha se këto janë rekomandime të raportit tonë që i ka miratuar edhe Kuvendi. Ne kemi kërkuar që të kompensohen qytetarët për energjinë e faturuar, në mënyrë të kundërligjshme. Ne, kur e kemi parë që ZRRE-ja nuk po vepron, atëherë e kemi dërguar lëndën në gjykatë. ZRRE-ja edhe për ligjet për konflikte administrative, pasi që tash çështja ka shkuar në gjykatë, mund të anulohet vetë vendimin. Pra, është neni 36 i Ligjit për konflikte administrative, i cili thotë nëse se një organ administrativ e sheh të paarsyeshëm një vendim, të cilin e ka nxjerrë, mund të nxjerrë një vendim tjetër. Nëse ZRRE-ja vendos të zbatojë një gjë të tillë, ne e tërheqim padinë.

**Petrit Pepaj**, tha se vendimi është marrë në vitin 2012 dhe ka pasur validitet për 5 vjet, për shkak se kështu e thotë ligji, ndërsa në vitin 2018, ky vendim nuk ka asnjë fuqi ligjore. ZRRE-ja ka nxjerrë një vendim të ri për parametra rregullatorë për periudhën e ardhshme 2018-2022. Me vendimin e ri, qytetarët e vendit nuk paguajnë për katër komunat veriore, me vendimin e ri janë zvogëluar tarifatat për 3.5%, ndërsa për bizneset 5%. Nuk e di se çfarë kalkulime do të dalin në vitin e ardhshëm, ndoshta duhet të zbriten prapë ndoshta del që nuk duhet as të rriten, as të zbriten, por ndodh që këto janë kalkulime me metodologjinë, për të cilat ZRRE-ja është e detyruar t'i respektojë, sepse nuk mund të punojë jashtë rregullave.

**Shemsi Sylja**, pyeti: A janë duke u shkelur të drejtat e qytetarëve edhe tani kur janë marrë disa masa?

**Suzana Gashi**, tha se nëse gjykata e ka shfuqizuar një vendim të ZRRE-së, pa marrë parasysh se a ka qenë i vitit 2012, ajo ka qenë një shkelje e vazhdueshme. Ne e dimë që një akt administrativ mund të sfidohet në gjykatë, brenda 30 ditëve, eventualisht 60, por meqenëse ka qenë shkelje e vazhdueshme, Gjykata Themelore e ka hequr shfuqizuar atë vendim, pa marrë parasysh që ZRRE-ja tash ka marrë një vendim të ri, këtu kemi të bëjmë me koncepte juridike. Ne po presim prej Gjykatës Themelore, që të anulohet këtë vendim të ZRRE-së, mirëpo pasojat që ai vendim i ka shkaktuar duhet të kompensohen. Ne kemi dhënë një zgjidhje, të miratohet zbritja e tarifave deri në atë masë sa të barazohet kompensimi. Kjo është zgjidhja e vetme që kemi pasur si mundësi. Ajo se çka ka bërë ZRRE-ja, që e ka ndalur faturimin, është në frymën e asaj që kemi kërkuar, do të thotë, një herë për një herë, është ndalur faturimi.

## 2. Të ndryshme

Anëtarët e komisionit diskutuan, lidhur me mundësinë e mbajtjes së një punëtorie për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe mundësinë për gjetjen e donatorëve, që të mund të mbështesin këtë punëtori.  
U vendos që një kërkesë e tillë t'i drejtohet OSBE-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje